



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.16/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 515/2018, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha - Blakqori, pala ankuese nga fshati , me të autorizuarin dhe Përmbarduesi Privat, me datën 14.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-16/2022 i datës 17.05.2022, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese,

si të pabazuara.

II. Përmbarduesi privat si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr. 515/2018 të datës 20.12.2018.

A r s y e t i m

Me datën 12.05.2022, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbarduesit Privat , me të cilën ka pretenduar se përmbarduesi privat, në mënyrë të vetëdijshme

dhe me qëllim të pasurimit personal, përmbaruesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, duke nxjerrë vendim të kundërligjshëm dhe duke e rrezikuar skajshmërisht mirëqenien e familjes së palës ankuese, pasi që jeton me ndihma sociale. I ka propozuar komisionin që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbaruesi privat.

Me datën 17.05.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit privat, lidhur me veprimet përmbarimore për këtë lëndë.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka theksuar se shkresat e lëndës sipas kërkesës së kreditorit janë transferuar nga gjykata për vazhdim të procedurës përmbarimore tek përmbaruesi dhe përmbaruesi bazuar në lejimin e përmbarimit që është bërë nga gjykata vetëm i ka vazhduar veprimet tjera përmbarimore.

Përmbaruesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën dëgjimore ka theksuar se ankesa për fillimin e procedurës disiplinore është parashtruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara sipas nenit 375 të LPP-së. I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar e po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbaruesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, së paraqitur me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim që Përmbaruesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, pasi vlerësoi pretendimin e palës ankuese, gjeti se ankesa e parashtruar nga pala ankuese është iniciuar si procedurë pas afatit të përcaktuar ligjor me nenin 375 të LPP-së, ngase pala ankuese ka rënë në dijeni për veprimet e përmbaruesit privat me datë 14.01.2019, siç e deklaroi vetë pala ankuese në seancë dëgjimore, ndërsa ankesën e ka paraqitur, me datë 12.05.2022. Nga kjo rezulton se ankesa është paraqitur për më tepër se tri vite, nga dita kur ka rënë në dijeni pala ankuese për veprimet përmbarimore, pasi që afati për iniciimin e kësaj procedure

sipas dispozitës së lartcekur është nga 6 muaj, por jo më vonë se 1 vit nga dita e shkeljes së pretenduar. Për këto arsye komisioni nuk u lëshua më tutje në vlerësimin se përmbaruesi privat ka bërë apo nuk ka bërë veprime përmbarimore për të cilat pretendon pala ankuese, të përcaktuara me nenin 367 të LPP-së

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr.16/2022 datë 14.07.2022



Kryesuesja e Komisionit Disiplinor
Manushe Karaçi

Manushe Karaçi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.